



V E N D I M

Nr. 81, datë 3.2.2016

P Ë R

**KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT  
TË MENAXHIMIT TË BORXHIT DHE ANALIZËS FINANCIARE  
(SMBAF)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Borxhit dhe Analizës Financiare (SMBAF), i cili përmban të dhëna për kreditorin, huamarrësin, termat dhe kushtet financiare për çdo kredi dhe letër me vlerë, shtetërore e të garantuar, sektorin për të cilin shpërndahen fondet e kredisë/letrës me vlerë si dhe kurset e këmbimit. Sistemi pasqyron të dhëna faktike dhe kryen parashikime në përputhje me termat financiarë të marrëveshjeve përkatëse.
2. Përbërësit e arkitekturës *software* dhe *hardware* të sistemit miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.
3. Të dhënat që përmban sistemi janë vetëm të dhëna parësore, pasi ai nuk merr të dhëna nga sisteme të tjera. Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e gjeneruara nga SMBAF-i dhe që kanë të bëjnë me:
  - a) informacion për huadhënësin;
  - b) huamarrësin;
  - c) termat dhe kushtet e kredisë/letrës me vlerë;
  - ç) disbursimet;



- d) shërbimet e borxhit;
- dh) kurset e këmbimit.

Sistemi bën të mundur prodhimin e raporteve të ndryshme mbi borxhin e jashtëm.

4. Subjekti përgjegjës për administrimin e sistemit SMBAF është Ministria e Financave.
5. Dhënës i informacionit për sistemin është Ministria e Financave.
6. Subjekte të interesuara janë:
  - a) Ministria e Financave;
  - b) Banka e Shqipërisë;
  - c) Banka Botërore;
  - ç) Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN);
  - d) EUROSTAT-i;
  - dh) agjencitë e *Credit Ratings*;
  - e) ministritë e linjës/insitucione që zbatojnë projekte që financohen me kredi të huaja, etj.
7. Niveli i aksesit në sistemin dhe në bazën e të dhënave të SMBAF-it është, si më poshtë vijon:
  - a) **Regjistruet:** regjistron informacion për marrëveshjet e kredive, kreditorët, huamarrësit, disbursimet, pagesat, kurset e këmbimit, normat e interesit etj.;
  - b) **Përdorues vetëm lexues:** kjo kategori përdoruesish nuk është e lejuar të regjistrojë informacion në sistem. Përdoruesit e kësaj kategorie mund të ekzekutojnë vetëm raporte dhe t'i përdorin ato për qëllime raportimi;
  - c) **Administratorët e sistemit:** administratorët e sistemit janë administratorë teknikë, të cilët mirëmbajnë e administrojnë teknikisht sistemin dhe përdoruesit e sistemit SMBAF.
8. Ministria e Financave ka të drejta administrative mbi SMBAF-in, në rolet:
  - a) Administrator;
  - b) Raportues;
  - c) Auditues.
9. Baza e të dhënave të SMBAF-it nuk ndërvepron me baza të tjera të dhënash.

10. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

MINISTRI I FINANCAVE

*Shkëlqim Cani*  
SHKËLQIM CANI

NR.PROT.6279/3  
DATË 5.2. 2016

MINISTRISË SË FINANCAVE  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
MINISTRIT TË SHTETIT PËR INOVACIONIN DHE  
ADMINISTRATËN PUBLIKE  
MINISTRIT TË SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME  
PARLAMENTIN  
KOMISIONIERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
AKSHI  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGACI**



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjëll Agaci', is written over a circular blue official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top and 'MINISTRATË E FINANCËVE' at the bottom.